

20110471294

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR TË MIRA AUDIOVIZUELE**

Neni 1

Në Ligjin për të mira audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 103/2008) pas nenit 41 shtohen dy nene të reja 41-a dhe 41-b, si vijojne:

"Ftesa për edukim

Neni 41-a

(1) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori i kultures konstaton se eshte kryer parregullsi që sipas ketij ligji eshte percaktuar si kundervajtje nga neni 42 i ketij ligji, ka për detyre që të perpiloje procesverbal në të cilin do ta percaktoje parregullsine e kryer me sugjerim për menjanimin e parregullsise së konstatuar në afat prej tete ditesh dhe me dorezim të njekohshem të fteses për realizimin e edukimit personit ose subjektit, ku eshte konstatuar parregullsia gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Formen dhe permbajtjen e fteses për edukim, si dhe menyren e realizimit të edukimit i percakton ministri i kultures.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Ministria e Kultures, në afat jo më të gjate se tete dite nga dita e kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shume parregullsi të konstatuara të njejta ose të ngjashme për një ose më teper subjekte.

(5) Nese në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi eshte realizuar.

(6) Nese personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se eshte edukuar lidhur me parregullsine e konstatuar.

(7) Nese inspektori i kultures gjate kryerjes së mbikeqyrjes kontrolluese konstaton se jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi 1 i ketij neni, miraton konkluzion me të cilin e nderpret proceduren e mbikeqyrjes inspektuese.

(8) Nese inspektori i kultures gjate kryerjes së mbikeqyrjes kontrolluese konstaton se nuk jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi 1 i ketij neni, parashtrohet kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje para komisionit për kundervajtje.

(9) Ministria e Kultures mban evidence për edukimin e realizuar në menyren e percaktuar nga ministri i Kultures.

Publikimi i raportit

Neni 41-b

Ministria e Kultures për kontrollet e kryera perpilon raporte tremujore dhe i publikon në ueb faqen e Ministrise së Kultures në pasqyre të unifikuar tremujore."

Neni 2

Neni 42 ndryshohet si vijon:

"(1) Gjoke në shume prej 500 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje personit juridik, nese nuk mban evidence dhe dokumentacion të të mirave audiovizuele (neni 31 paragrafi (1)).

(2) Gjoke në shume prej 300 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni edhe personit pergjegjes në personin juridik."

### Neni 3

Pas nenit 42 shtohen dy nene të reja 42-a dhe 42-b, si vijojne:

#### "Neni 42-a

(1) Gjoke në shume prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit fizik, nese:

- kryen veprimtari pa aktvendim se i ploteson kushtet për fillim të punes në kinoteke (neni 9 paragrafi (2)),
- nuk dorezon në Kinoteken e Maqedonise kopje të paperdorur tonike të së mires, menjehere pas realizimit të vepres (neni 20 paragrafi (2)),
- nuk i dorezon në Kinoteken e Maqedonise materialet burimore të të mirave audiovizuele dy vjet pas prezantimit të tyre të pare (neni 20 paragrafi (3)),
- nuk dorezon në Kinoteken e Maqedonise një kopje të paperdorur tonike të së mires, menjehere pas realizimit të saj (neni 20 paragrafi (4)),
- nuk i dorezon në Kinoteken e Maqedonise materialet burimore të të mirave audiovizuele dy vjet pas prezantimit të pare (neni 20 paragrafi (5)),
- nuk dorezon në Kinoteken e Maqedonise një kopje të paperdorur (neni 20 paragrafi (7)),
- nuk kryen revizion të të mirave audiovizuele (neni 29) dhe
- në afatin e caktuar në menyre profesionale nuk e perpunon të miren audiovizuele (neni 32 paragrafi (4)).

(2) Gjoke në shume prej 700 deri në 1000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni edhe personit pergjegjes në personin juridik.

#### Neni 42-b

(1) Për kundervajtjet e percaktuara në nenin 42 të ketij ligji, procedure për kundervajtje udheheq dhe sanksion për kundervajtje shqipton Ministria e Kultures (në tekstin e metejme: Organi për Kundervajtje).

(2) Për kundervajtjet e percaktuara në nenin 42-a të ketij ligji, procedure për kundervajtje udheheq dhe sanksionin për kundervajtje shqipton gjykata kompetente.

(3) Proceduren për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni, para Organit për kundervajtje e udheheq Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje (në tekstin e metejme: Komisioni për Kundervajtje) i formuar nga ministri i Kultures.

(4) Komisioni për Kundervajtje perbehet prej nepunesve të autorizuar zyrtare të punesuar në Ministrine e Kultures, prej të cileve njeri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit për Kundervajtje.

(5) Komisioni për Kundervajtje perbehet prej tre anetareve dhe zevendesve të tyre si vijon:

- dy juriste të diplomuar, prej të cileve njeri me provim të dhene të jurisprudences me pese vjet pervoje pune në sferen e vet dhe
- një anetar me perгатitje të larte profesionale nga fusha e shkencave shoqerore me pese vjet pervoje pune në sferen e vet.

(6) Komisioni për Kundervajtje zgjidhet për kohezgjatje prej tri vitesh me të drejte rizgjedhjeje të anetareve.

(7) Kryetar i Komisionit për Kundervajtje mund të zgjidhet vetem jurist i diplomuar me provim të dhene të jurisprudences.

(8) Komisioni për Kundervajtje për Organin për Kundervajtje vendos për kundervajtjet e percaktuara me kete dhe me ligj tjetër dhe shqipton sanksione për kundervajtje të percaktuara me kete ligj, Ligjin për kundervajtje dhe me ligj tjetër.

(9) Krah as anetareve të Komisionit për Kundervajtje, ministri i Kultures mund të caktojë sekretar të Komisionit për Kundervajtje që kryen pune administrative për Komisionin.

(10) Komisioni për Kundervajtje miraton rregullore për punen e vet.

(11) Kunder aktvendimeve të Komisionit për Kundervajtje, me të cilat shqiptohet sanksion për kundervajtje mund të parashtrohet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykates kompetente."

#### Neni 4

Në nenin 43 paragrafi (1) pas numrit "42" shtohen fjalet: "dhe nenin 42-a".

Në paragrafin (2) fjalet: "Kur kryeresi i kundervajtjes pajtohet për ngritjen procedures për barazim, inspektori" zevendesohen me fjalen "Inspektori".

Në paragrafin (4) fjala "mund" shlyhet, ndersa fjalet: "t'i jape" zevendesohen me fjalet: "i jep".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Konsiderohet se kryeresi i kundervajtjes me nenshkrimin e pranimi të urdherpageses pajtohet që ta paguaje gjoben."

#### Neni 5

Neni 44 shlyhet.

#### Neni 6

Aktet nenligjore të parapara me kete ligj, do të miratohen në afat prej 15 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".